

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Tregëtia Ndërkombëtare dhe E drejta e Investimeve
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla D4
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Mejdi Bektashi
Detajat kontaktuese:	<a href="mailto:mejdi.bektashi@uni-pr.edu">mejdi.bektashi@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<i>Lënda elaboron teoritë e ndryshme mbi tregtinë ndërkombëtare, investimet direkte të huaja dhe financimin e jashtëm. Shpjegon lidhjen në mes të tregtisë ndërkombëtare dhe mjedisit, rolin kritik që luan tregëtia ndërkombëtare nënë rritjen, zhvillimin dhe forcimin ekonomik të shtetit. Do të diskutohet ndryshimin i mjedisit tregëtar si çeshtje bazë e strategjisë biznesore dhe politikës kombëtare ekonomike. Lënda prezenton metodat dhe konceptet kryesore të tregëtisë ndërkombëtare, posaçërisht transaksionet e tregëtisë ndërkombëtare. Gjithashtu do të analizohet dhe paraqitet në disa fusha edhe rëndësia e arbitrazhit ndërkombëtar. Do të shtjellohen avantazhet komparative, modelet e tregëtisë, përfitimet nga tregëtia, proteksionizmin dhe efektet e tregëtisë në shpërndarjen e të ardhurave. Do të analizohen aspektet ekonomike dhe politike të barrierave tregëtare, ndërlidhja midis tregëtisë dhe zhvillimit ekonomik.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Lënda elaboron teoritë e ndryshme mbi tregtinë ndërkombëtare, investimet direkte të huaja dhe financimin e jashtëm. Shpjegon lidhjen në mes të tregtisë ndërkombëtare dhe mjedisit. Do të analizohet roli i avantazhit absolut (sipas Adam Smithit) si determinante e modeleve të tregëtisë. Gjithashtu do të analizohet roli i ekonomisë së shkallës, teknologjisë, kërkesës, kostos së transportit duke spjeguar modelet e tregëtisë. Do të diskutohen politika ekonomike dhe e tregëtisë. Lënda shtjellon rolin e tregëtisë ndërkombëtare për shtetet në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion, nga</i>

	<p>sistemet me ekonomi të planifikuar në sistemet ekonomike të bazuar në tregje. Lënda analizon kornizën ligjore për rregullimin e marrdhënieve ndërmjet investitorëve të huaj dhe shtetit.</p>		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të ketë njohuri dhe aftësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbi konceptet bazike të tregëtisë ndërkombëtare</li> <li>• Shpjegimi i ngjarjeve kryesore dhe fenomeneve që ndërlidhen me çështjet e tregëtisë ndërkombëtare</li> <li>• Familjarizim mbi teoritë e ndryshme për tregtinë ndërkombëtare, investimet direkte të huaja dhe financimin e jashtëm.</li> <li>• Analizë të kornizës ligjore për rregullimin e marrdhënieve ndërmjet investitorëve të huaj dhe shtetit.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>173.5 orë</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Pas ligjërates hyrëse prej dy orëve, mësimi i modulit do të bëhet përmes ligjëratave prej një ore dhe seminareve po ashtu njëorëshe çdo javë. Lista e materialeve për lexim dhe pyetjeve për seminar do të shpërndahet paraprakisht dhe nga studentët pritet të përgatisin përgjigjet për diskutime në seminare.</p>		

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>20%: Pjesëmarrja në diskutimet në klasë.</p> <p>20%: Gjatë semestrit, ne do të mbulojmë disa grupe të problemeve. Secili student do të jetë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e një problemi të vendosur gjatë semestrit. Studenti do të shkruajë një punim tre-deri në pesë-faqesh (me hapësirë të dyfishtë mes rreshtave, shkronja 12-pikëshe Times New Roman, margjina e faqes 1 ") duke analizuar problemet.</p> <p>Studenti do të ketë 10-15 minuta gjatë orës për t'ia shpjeguar klasës problemin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Kjo detyrë do të përfaqësojë 20% të notës së secilit nxënës.</p> <p>60%: provimi.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Paul R. Krugman &amp; Maurice Obstfeld: <i>International Economics, Theory and Policy, 7th Edition, Pearson Education, 2006;</i></li> <li>2. Robert Gilpin: <i>Ekonomia politike globale, Kuptimi i rendit ekonomik ndërkombëtar, ISP&amp;Dita 2000, Tiranë 2009.</i></li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Amartya Sen: <i>Zhvillimi si liri, Tiranë, 2009;</i></li> <li>2. OECD Benchmark definition of foreign investment, <a href="http://www.oecd.org">www.oecd.org</a>.</li> <li>3. Sornorojah, M.: " <i>The International Law and Foreign Investment</i>" Cambridge University Press, 1999.</li> <li>4. Manfred B. Steger: <i>Globalizimi – Hyrje e shkurtwr.Co-Plan, Tiranw, 2005</i></li> <li>5. Robert C. Feenstra, <i>Advanced International Trade: Theory and Evidence, Princeton University Press, 2004, ISBN 0-691-11410-2</i></li> <li>6. Feenstra, Robert C., <i>Advanced International Trade: Theory and Evidence, 2004, Princeton and Oxford: Princeton University Press, pp. xii, Advanced 484.</i></li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Sistemi tregtar, Debate mbi tregtinë dhe analia komparative, Tregtia dhe ekonomia
<b>Java e dytë:</b>	Rishikimi i teorisë së tregtisë konvencionale, Integrimi i tregtisë ndërkombëtare dhe investimet e huaja, Avantaxhi krahasues dhe avantazhi konkurrues, Teoria e re e tregtisë, Ruandi i Urugvajit dhe OBT.
<b>Java e tretë:</b>	Shteti dhe korporatat multinacionale, Investimet e huaja dhe KM, KM dhe ekonomia ndërkombëtare, Debate mbi KM dhe shtetin kombëtar, Një regjim ndërkombëtar për Investimet e Huaja Direkte dhe KM, A janë të kërcnuara korporatat globale?

<b>Java e katërt:</b>	Qeverisja e ekonomisë globale, Institucionalizimi neoliberal, Reforma institucionale, Mesjetarizimi i ri
<b>Java e pestë:</b>	Teoria e tregtisë ndërkombëtare, Kush me kend tregon?, Formula e ndryshuar e tregtisë ndërkombëtare, A vlejë ende rregullat e vjetra?
<b>Java e gjashtë:</b>	Resurset, përparësitë komparative dhe shpërndarja e të së ardhurës, çmimet dhe prodhimi, Efektet e tregtisë ndërkombëtare, Çmimi i faktorëve, çmimi i mirave dhe zgjedhja e inputeve.
<b>Java e shtatë:</b>	Ekonomia e vëllimit dhe tregtia ndërkombëtare, Ekonomia e vëllimit dhe struktura e tregut, Konkurrenca monopolistike dhe tregtia, Dampingu, Ekonomia eksterne dhe tregtia ndërkombëtare.
<b>Java e tetë:</b>	Lëvizjet ndërkombëtare të faktorëve të prodhimit, mobiliteti ndërkombëtar i punës, Kredimarrje dhe kredinjënje ndërkombëtare, Investimet e huaja direkte dhe Korporatat Ndërkombëtare.
<b>Java e nëntë:</b>	Instrumentet e politikës tregtare, Analiza e doganave, Kostot dhe dobitë nga doganat, Instrumentet tjera të politikës tregtare.
<b>Java e dhjetë:</b>	Ekonomia politike e politikës tregtare, Argumentet për tregti të omp, Shpërndarja e të ardhurave dhe politika tregtare, Bisedat ndërkombëtare dhe politika tregtare.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Mospajtimet rreth politikave tregtare, Shtetet në zhvillim, shtimi, kriza dhe reforma.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Politikat tregtare dhe Kosova, CEFTA dhe Kosova. Investimet e Huaja Direkte dhe Kosova, Faktorët që pengojnë tërheqjen e IHD, Analiza komparative sa i përket politikave tregtare dhe IHD. SHTESA Llojet e investimeve të huaja Kriteret e ndarjes së investimeve të huaja Definimi juridik I IHD Teoria ekonomike e IHD Investimet portfolio Format e reja të investimeve

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p><b>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;</li> <li>• Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);</li> <li>• Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimimit;</li> <li>• Mbjajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.</li> </ul>

***Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:***

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*